



THIRRJE PËR OFERTIM

CALL FOR OFFER

Titulli i projektit / Project Title:	GREEN IMPACT "Global Resilience through Educational Environmental Networks for Institutional Management, Professional Advancement and Community Transformation"
Titulli i aktivitetit / Activity Title:	Blerje e paisjeve për qëllim të implementimit të projektit
Numri i referencës së projektit / Project Reference Number	101237617
Agjencia donatore / Sponsoring Agency:	Erasmus+ CBHE
Periudha e implementimit të projektit/ Project Implementation Period:	36

1. Informata rreth Kolegjit AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë i cili është themeluar menjëherë pas luftës në Kosovë, pas krijimit të rrethanave të reja ekonomike-sociale e kulturore, kur u krijuan kushte dhe rrethana për jetë normale të qytetarëve të Kosovës. Në fillimet e tij institucioni ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv duke u zgjeruar vazhdimisht me programe studimore në fushat e tjera dhe duke u shndërruar kështu në institucion model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Sot, Kolegji AAB ofron programe studimi të nivelin baçelor dhe master në 14 fakultete të ndryshme. Njëkohësisht, Kolegji AAB është implementues i shumë projekteve ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

2. Informata të përgjithshme rreth projektit

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të projektit ***Global Resilience through Educational Environmental Networks for Institutional Management, Professional Advancement and Community Transformation***, projekt i cili përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt integritimit të qëndrueshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor.

Në kohën kur rajoni po kalon tranzicionin e gjelbër në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, kjo iniciativë fuqizon universitetet që të udhëheqin ndryshimin mjedisor përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse institucionale, duke integruar qëndrueshmërinë në qeverisje, kurrikula, kërkim shkencor dhe operacione. Përmes një kornize të përshtatur për vetëvlerësimin institucional, mikro-kredencialeve për aftësi të gjelbra dhe aktiviteteve praktike për ngritjen e kapaciteteve, GREEN IMPACT do të ndihmojë në ngushtimin e hendekut ndërmjet politikave dhe zbatimit të tyre në praktikë, duke i aftësuar institucionet e arsimit të lartë të udhëheqin kalimin drejt ekonomisë qarkore, qëndrueshmërisë klimatike dhe reduktimit të ndotjes. Ndikimi transformues i projektit do të shtrihet përtej arsimit të lartë, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet universiteteve të tjera dhe institucioneve arsimore (përfshirë studentët e tyre), të cilët



do të përdorin kornizën dhe programet e trajnimit GREEN IMPACT për të krijuar një ekosistem rajonal më të qëndrueshëm. Projekti financohet nga programi Erasmus+ Capacity Building in Higher Education (CBHE) i Bashkimit Evropian.

3. Objekti i ofertës

Të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë ftohen që të dorëzojnë ofertat e tyre për blerjen e pajisjeve të listuara në vijim:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve/	Specifikat teknike të pajisjeve	Sasia
1	Laptop	Laptop Lenovo Yoga 7 2in1 14ILL10,14.2", Intel Core Ultra 7 258V, 32GB RAM, 1TB SSD, Intel Arc Graphics 140V	1
2	Laptop	Lenovo Yoga Slim 7 14AKP10 AMD RYZEN AI 7 350 32GB/1 TB SSD	2
3	Computer	AIO Lenovo ThinkCentre neo 50a GS 27 / i7-13620H / 16GB DDR5 / 512GB / 27" Full HD IPS / Tastiere+Maus /Intel UHD Graphics	2
4	Computer	AIO Lenovo IdeaCentre 27 ARR9 / Ryzen 5 7535HS / 16GB / 512GB / 27" Full HD IPS AG / integrated AMD Radeon / Maus + Tastier	2
5	Laptop	Lenovo ThinkPad L13 Yoga i5 1335U 256GB, 16GB, DDR5, 13.3", WUXGA	3

4. Kushtet dhe kriteret për aplikim

Të gjitha bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ofertën financiare (bazuar në specifikat, çmimin e ofruar për njësi dhe kohën e liverimit).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Certifikatën e TVSH-së

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në formë elektronike në email-in dardan.krekaj@universitetiaab.com dhe projects@universitetiaab.com me subject "Ofertë për "GREEN IMPACT". Çdo formë tjetër e dorëzimit të ofertave do të konsiderohet e papranueshme.

Afati për dorëzimin e ofertave është më 02.04.2026 në ora 16.00.

Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në bazë të kriterëve si në vazhdim: çmimit ekonomikisht më të favorshëm (40 pikë), përmbushjes së specifikave teknike (40 pikë), dhe kohës së liverimit (20 pikë).